
RECENSIONE

FATMIRA MUSAJ: REPUBLIKA SHQIPTARE (1925-1928),
Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë,
Tiranë: 2018, 774 f.

Sikurse nuk pritej, rrëzimi i sistemit komunist, nuk solli një shtim të vullshëm të studimeve mbi figurën e Ahmet Zogun dhe vitet në të cilat ai drejtoi Shqipërinë si president (1925-1928) e monark (1928-1939). Në përgjithësi, botimet rishtarë me këtë fokus, qenë të pakta, shpeshherë duke përsëritur fakte të njohura. Në këtë aspekt çdo studim me burime të besueshme për periudhën në fjalë është i mirëpritur dhe konsiderohet një punë pioniere. E tillë është edhe monografia e profesore Fatmira Musaj “Republika Shqiptare 1925-1928”.

Spektri i tematikës së këtij studimi rrok procese dhe figura historike, të cilat ose janë trajtuar në formë të ideologjizuar nga historiografia komuniste, ose janë mbuluar nga pluhuri i harresës, duke përbërë një njollë të bardhë në botën e hulumtimeve. Në këndvështrimin e lexuesit, studimi sjell informacion të larmishëm historik, paraqitur me elegancë dhe kulturë gjuhësore, produkt i një pune të gjatë e me shumë lodhje. Qartazi përgjatë leximit, ndjehen ngjashmëritë e të shkuarës me të tashmen, veçanërisht për sa i përket fenomeneve që lidhen me psikologjinë e drejtimit, forcën e “njëshit”, korrupsionin në radhët e strukturave shtetërore, sjelljen ndaj kundërshtarëve politikë, problemet me proceset zgjedhore, marrëdhënien e vështirë të shqiptarëve me ligjin dhe zbatimin e tij.

Monografia “Republika Shqiptare 1925-1928” mbështetet mbi një bazë të shëndoshë burimore, ku spikat shfrytëzimi gjerësisht dhe imtësisht i regjistrimeve arkivore relevante, një element ky që ka ndikuar në shkallën e autenticitetit të studimit. Pjesë e rëndësishme e bibliografisë është edhe literatura historiografike, e cila jo vetëm i ka dhënë mundësinë autores të qëmtojë fakte të shumta, por edhe të ballafaqohet me pikëpamje, interpretime dhe analiza ndaj të cilave është mbajtur qëndrim.

Në lidhje me metodologjinë, studimi karakterizohet kryesisht nga paradigma pozitiviste, që nënkupton hartimin e një historie politike, mbështetur në dokumentet e shkruara, apo “faktet historike”, të cilat dalin përgjithësisht nga burimet arkivore. Libri në tërësinë e tij është shkruar në stilin tradicional të historishkrimit të ngjarjeve dhe fenomeneve me natyrë politike, duke u bazuar në interpretimin pozitivist të burimeve. Megjithëse, hulumtimi i sotëm ndërkombëtar është orientuar nga aspekte të historisë kulturore dhe sociale, libri i profesores Fatmira Musaj përbën vlerë, për sa i përket nivelit të

hulumtimeve mbi vitet e Republikës Shqiptare dhe në procesin e shtetformimit tek shqiptarët.

Studimi konsiderohet i rëndësishëm posaçërisht në kuadrin e procesit të përpunimit objektiv të historisë. Qëndrimi i përmbajtur i historianëve, duke nisur nga vitet 90' i hapi derë e dritare publicistikës. E fokusuar kryesisht mbi lajme sensacionale me baza burimore dhe reportazhe të dyshimta, publicistika gjithnjë e në rritje ka banalizuar e diskretitur procesin e përpunimit objektiv të historisë, duke i paraqitur publikut aspekte kryesisht rozë, sensacionale dhe të paargumentuara të saj. Pikërisht për këtë arsye studimi tërësisht shkencor mbi vitet e Republikës Shqiptare mbart në vetvete një rëndësi të veçantë, jo vetëm për rrethet akademike, por edhe për opinionin publik shqiptar.

Monografia “Republika Shqiptare, 1925-1928” mbështetet në një qasje tematike-kronologjike, të mirëmenduar, që i shërben më së miri analizës dhe argumentimit shkencor. Ajo përbëhet nga shtatë kapituj.

Kapitulli i parë i titulluar: *Rënia e qeverisë së Iljaz Vrionit dhe përpjekjet për t'u rikthyer në pushtet (qershor-dhjetor 1924)*, vjen në kuadrin e një kapitulli hyrës. Si i tillë ai trajton historinë gjashtëmujore nga qershori i 1924-ës, kur Ahmet Zogu u largua nga Shqipëria deri në dhjetor të po atij viti, kur ai rimori pushtetin. Ngjarjet përcillen tek lexuesi në mënyrë dinamike. Paraqiten të ndërthurura me kujdes e profesionalizëm lëvizjet shumëdimensionale të Ahmet Zogut për të rimarrë pushtetin dhe penguar legjitimimin e qeverisë së Fan Nolit.

Kapitulli i Dytë: *Ahmet Zogu në krye të Republikës Shqiptare*, trajton me detaje masat e ndërmarra dhe mjetet e përdorura nga A. Zogu për legjitimimin dhe konsolidimin e pushtetit, fill pas largimit të Fan Nolit dhe qeverisë që ai drejtonte. Vëmendje i kushtohet përcaktimit të formës së regjimit, organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve parlamentare dhe atyre të pushtetit lokal. Me kujdes është evidentuar rëndësia që Ahmet Zogu i jepte aspektit kushtetues, si një hallkë e rëndësishme për legjitimimin e pushtetit dhe konsolidimin e shtetit. Interes të shtuar vijon e mbart përgjigjja e pyetjes nëse Zogu ishte aq institucional sa shfaqej prej vullnetit të tij, apo në saje të zbatimit me kujdes të këshillave të ministrit Fuqiplotë britanik, Ayres.

Vëmendja e duhur, shoqëruar me një analizë të thukët, me të drejtë i është dhënë Statutit të Republikës Shqiptare. Autorja jo vetëm ka paraqitur me kujdes nenet e tij, por i ka analizuar ato duke vënë në dukje centralizimin e pushtetit. I arrirë është në këtë kapitull edhe trajtimi i përpjekjes së Ahmet Zogut për të shtrirë autoritetin e shtetit në të gjithë vendin, si një hap vendimtar që do të siguronte qëndrueshmëri për pushtetin e tij. Si një lojtar i shkëlqyer i politikës dhe njohës po i tillë i mentalitetit të shqiptarëve, ai u përkushtua totalisht në aksionin për mbledhjen e armëve, dënimin fillimisht e më tej amnistinë e një pjese të kundërshtarëve politikë, si edhe mënjanimin e qëndrimeve krahinariste të parisë së vendit. Masat e marra në favor të unitetit politik dhe centralizimit të

qeverisjes, në rezultat final do të sillnin stabilitetin politik, aq shumë të nevojshëm në Shqipërinë e kohës. Në këndvështrimin e profesore Musajt, masat për ngritjen e institucioneve kushtetuese dhe legjitimitimin e pushtetit, nuk duhen konsideruar të veçuara nga përpjekjet e Ahmet Zogut për të siguruar mbështetje financiare, pa të cilën ishte e vështirë të garantohej qëndrueshmëria politike. Nën këtë arsyetim, me të drejtë ajo ka bërë pjesë të këtij kapitulli edhe sigurimin e huasë nga Italia dhe themelimin e Bankës Kombëtare Shqiptare. Çështja e kundërshtarëve politikë, si fillesë e fenomenit të emigracionit politik jashtë Shqipërisë, si edhe lidhja e kundërshtarëve të A. Zogut me lëvizjen komuniste, janë aspekte për të cilat ka interes të gjerë edhe përtej komunitetit shkencor. Për këtë arsye, vëmendja karshi tyre mund të kishte qenë më e madhe, jo thjesht me synimin për të plotësuar boshllëkun, por për të analizuar pasojat në shoqërinë shqiptare.

Kapitulli i Tretë vjen i plotë, me analiza shkak-pasojë dhe fakte me interes për marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Italinë fqinje. Ngjarjet dhe aspekte të ndryshme që lidhen me zhvillimet e brendshme dhe marrëdhëniet me Jugosllavinë janë parë në funksion të këtyre marrëdhënieve. Kjo natyrë trajtimi vjen si risi në studimet shqiptare. Në këtë qasje trajtohen orvatjet e Beogradit për rrëzimin e A. Zogu. Ndërkohë, marrëdhëniet Zog-Musolini janë trajtuar me detaje në funksion të paraqitjes së rezistencës që Zogu i bën varësisë nga Italia. Në mendimin tonë, vëmendje më të plotë duhet të kishte marrë analiza e kujdestarisë që Italia fitoi ndaj shtetit shqiptar nga vendimi i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, më 9 nëntor 1921, si një faktor që kushtëzoi drejtpërdrejt marrëdhëniet shqiptaro-italiane dhe varësinë politike dhe ekonomike të Shqipërisë nga Italia.

Kuadri i politikës së jashtme të shtetit shqiptar është plotësuar në Kapitullin e Katërt, ku kanë zënë vend marrëdhëniet me Jugosllavinë, Greqinë, Turqinë dhe Egjiptin. Kryesisht këto janë parë në kuadrin e marrëdhënieve politike, duke lënë paksa mënjanë ato kulturore. Dalin qartë çështjet themelore përcaktuese të tyre, ku veçohet ndikimi që shqiptarët jashtë shtetit amë kanë pasur në to. Studiuesja është realiste dhe nuk rrëmbehet nga pasionet kur trajton raportet e Shqipërisë me fqinjët, Turqinë dhe Egjiptin. Trajtimi është objektiv, i balancuar e gjakftohtë.

Kapitulli i Pestë i kushtohet tërësisht administratës shtetërore dhe reformimit të saj. Procesi i reformimit të administratës shtetërore, shkëputja nga trashëgimia osmane dhe zbatimi i përvojës evropiane konsiderohen aspekte të rëndësishme në procesin e shtetformimit tek shqiptarët. Me një tematikë të tillë në fokus, ky kapitull ka ndërthurje të disa disiplinave shkencore dhe historia nuk paraqitet vetëm në aspektin politik të saj por edhe atë social. Me imtësi dhe me vëmendje maksimale janë analizuar të gjitha institucionet e administratës shtetërore, duke argumentuar nevojën për reformim, të metat që viheshin re, korrupsionin dhe përpjekjet për shkëputjen përfundimtare të Shqipërisë nga

përvoja osmane dhe rendja e saj drejt Perëndimit. Profesore Musaj ka arritur në përfundimin e drejtë se Ahmet Zogu kuptoi rëndësinë që hartimi dhe zbatimi i ligjit kishte për shoqërinë shqiptare, madje ai shfrytëzoi pjesën më të mirë të elitës shqiptare për hartimin e legjislacionit në përputhje me përvojën evropiane. Pavarësisht, se reformimi i administratës lokale mund të kishte marrë më shumë vëmendje, ky kapitull është solid dhe paraqet shumë interes.

Kapitulli vijues, i Gjashti në radhë, trajton me detaje elementë të politikës ekonomike të shtetit shqiptar. Ai përmban risi në fakte dhe interpretim. Në të janë paraqitur me kujdes si vëmendja që shteti shqiptar i dha masave për forcimin e ekonomisë, ashtu edhe varësia e pashmangshme nga Italia. Analizohen drejtë arsyet e situatës së vështirë ekonomike, ndërkohë që ndërhyrja italiane është evidentuar me kujdes dhe paanësi. Parimi i politikës së dyerve të hapura dhe konkurrencës së lirë, si një nga parimet ku mbështetej ekonomia botërore e kohës, mund të kishte marrë një vëmendje më të madhe, e përqendruar kryesisht tek aspekti teorik. Disi i vagullt mbetet fakti nëse qeveria shqiptare kishte strategji për zhvillimin ekonomik të vendit dhe në cilat degë fokusohesh vëmendja e saj.

Kapitulli që mbyll monografinë prek çështje të arsimit kombëtar, pavarësisht së komuniteteve fetare, impaktit të këtij procesi në marrëdhëniet me Greqinë. Tematika e tij plotësohet me vëmendjen që shteti shqiptar i kushtoi sektorit të shëndetësisë. Në tërësi materiali është solid, jep informacion rishtar, me interes nën interpretime të arsyeshme. Qasja sociale e tij e zgjeron fushëpamjen duke i trajtuar fenomenet në disa këndvështrime.

Në përfundim, monografia e përgatitur nga prof. Fatmira Musaj mbart vlerat e një studimi autentik, me interes shkencor e publik për një periudhë me orientim nga Perëndimi, me sfida të panumërta për historinë e shtetit shqiptar. Mbështetur në regjistrime arkivore relevante, në literaturë të pasur, e shkruar me kulturë, “Republika Shqiptare, 1925-1928” sjell e risjell në vëmendje procese e figura historike, duke u hequr pluhurin e harresës. Tashmë ata mbartin dimensione reale, ashtu siç e kërkon kodi i shenjtë i së vërtetës historike, të cilin profesore Fatmira Musaj e ka respektuar maksimalisht. Studimi vjen si sfidë në përballjen me botën akademike dhe lexuesin e kualifikuar, çka do të thotë se profesore Musaj ka prekur dhe hapur tema të reja, që të çojnë drejt debatit me referenca të mirëfillta shkencore, aq shumë i vlerë për shoqërinë shqiptare.

Ledia DUSHKU